



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.135

17 shtator

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.2, datë 16.9.2009	Për miratimin e përbërjes dhe Programit Politik të Këshillit të Ministrave	6267
Dekret nr.6265 datë 16.9.2009	Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit	6268
Akt normativ nr.3, datë 10.8.2009	Për dërgimin në Afganistan të një kompanie shtesë, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë	6269
Vendim i KM nr.848, datë 5.8.2009	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të spitalit ushtarak, Gjirokastrë, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	6270
Vendim i KM nr.853, datë 5.8.2009	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.7.2009, për çështjen nr.25336/04, “Groni kundër Shqipërisë”	6270
Vendim i KM nr.854, datë 5.8.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe në atë të mjekësisë, të Universitetit të Tiranës	6271
Vendim i KM nr.855, datë 5.8.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës.....	6274

Vendim i KM nr.856, datë 5.8.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në universitetin “Fan S. Noli”, të Korçës	6274
Vendim i KM nr.857, datë 5.8.2009	Për hapjen, në qytetin e Peshkopisë, të filialeve dhe të programeve të studimeve, të fakulteteve të ekonomisë e të administrimit, të edukimit dhe të shkollës së lartë profesionale, të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe për miratimin e kuotave të pranimi e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010	6275
Vendim i KM nr.861, datë 23.6.2009	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, agjencive të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të objektit “Reparti i prestarisë dhe zyra”, në administrim të “NPV ushtrisë”, sh.a., Tiranë	6277
Vendim i KM nr.862, datë 22.7.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit”, të ndryshuar	6277
Vendim i KM nr.864, datë 29.7.2009	Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010	6278

VENDIM
Nr.2, datë 16.9.2009

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE PROGRAMIT POLITIK TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 96,97,98 dhe 78 të Kushtetutës, bazuar më dekretin e Presidentit të Republikës nr.6244, datë 14.9.2009 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet përbërja e Këshillit të Ministrave si më poshtë:
1. Zoti Sali Berisha, Kryeministër
 2. Zoti Ilir Meta, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme
 3. Zonja Majlinda Bregu, Ministre e Integrimit
 4. Zoti Lulzim Basha, Ministër i Brendshëm
 5. Zoti Arben Imami, Ministër i Mbrojtjes
 6. Zoti Ridvan Bode, Ministër i Financave
 7. Zoti Dritan Prifti, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
 8. Zoti Bujar Nishani, Ministër i Drejtësisë
 9. Zoti Sokol Olldashi, Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
 10. Zoti Myqerem Tafaj, Ministër i Arsimit dhe Shkencës
 11. Zoti Petrit Vasili, Ministër i Shëndetësisë
 12. Zoti Spiro Ksera, Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
 13. Zoti Genc Ruli, Ministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
 14. Zoti Ferdinand Xhaferi, Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
 15. Zoti Fatmir Mediu, Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
 16. Zoti Genc Pollo, Ministër Shteti për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin
- II. Miratohet Programi Politik i Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6265, datë 16.9.2009

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË GJYQTARËVE PËR ÇDO GJYKATË
TË SHKALLËS SË PARË DHE TË APELIT**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 8 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë është si më poshtë:

1. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Berat, 11 gjyqtarë.
2. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Dibër, 5 gjyqtarë.
3. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, 24 gjyqtarë.
4. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Elbasan, 17 gjyqtarë.
5. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Fier, 16 gjyqtarë.
6. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, 13 gjyqtarë.
7. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Kavajë, 7 gjyqtarë.
8. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Korçë, 21 gjyqtarë.
9. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Krujë, 7 gjyqtarë.
10. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Kukës, 6 gjyqtarë.
11. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Kurbin, 6 gjyqtarë.
12. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Lezhë, 9 gjyqtarë.
13. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Lushnjë, 10 gjyqtarë.
14. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Mat, 4 gjyqtarë.
15. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Përmet, 4 gjyqtarë.
16. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Pogradec, 8 gjyqtarë.
17. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Pukë, 4 gjyqtarë.
18. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Sarandë, 9 gjyqtarë.
19. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër, 19 gjyqtarë.
20. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, 61 gjyqtarë.
21. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Tropojë, 4 gjyqtarë.
22. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Vlorë, 18 gjyqtarë.
23. Në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda Tiranë, 16 gjyqtarë.

Neni 2

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë të apelit është si më poshtë:

1. Në gjykatën e apelit Durrës, 10 gjyqtarë.
2. Në gjykatën e apelit Gjirokastrë, 6 gjyqtarë.
3. Në gjykatën e apelit Korçë, 6 gjyqtarë.
4. Në gjykatën e apelit Shkodër, 7 gjyqtarë.
5. Në gjykatën e apelit Tiranë, 25 gjyqtarë.

6. Në gjykatën e apelit Vlorë, 10 gjyqtarë.
7. Në gjykatën e apelit për krime të rënda, 11 gjyqtarë.

Neni 3

Numri i gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së rrethit gjyqësor Tiranë bëhet:

- a) 64 gjyqtarë në 1 shtator 2010;
- b) 67 gjyqtarë në 1 shtator 2011;
- c) 70 gjyqtarë në 1 shtator 2012.

Neni 4

Dekreti nr. 706, datë 7.12.1993 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe të ndihmësgjyqtarëve” dhe dekreti nr. 1111, datë 30.05.1995 “Për një shtesë në numrin e gjyqtarëve dhe të ndihmësgjyqtarëve të gjykatave të rretheve”, shfuqizohen.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

AKT NORMATIV
Nr.3, datë 10.8.2009

PËR DËRGIMIN NË AFGANISTAN TË NJË KOMPANIE SHITESË, TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin në Afganistan të një kompanie shtesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

Neni 2

Misioni i autorizuar i kësaj kompanie është ruajtja dhe sigurimi i bazës, objekteve, personave të rëndësishëm, si dhe kryerja e shërbimeve në pikat e kontrollit.

Neni 3

Ushtarakët, që do të marrin pjesë, për ditët e qëndrimit në këtë mision, veç pagës mujore, do të marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, të njëjtë me atë të ushtarakëve, që dërgohen në mision, në përputhje me ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar.

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 7.7.2009, për çështjen nr.25336/04, “Groni kundër Shqipërisë”, në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëshmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 7.9.2009.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Arben Groni, dhe të konvertohet në lekë, sipas kursit të këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

5. Pagesa e kësaj shume në favor të ankuesit, z. Arben Groni, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.854, datë 5.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE DHE NË ATË TË MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në:

a) Filozofi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Filozofi”.

b) Sociologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sociologji”.

c) Pedagogji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Pedagogji”.

ç) Psikologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Psikologji”.

d) Punë sociale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Punë Sociale”.

2. Hapjen në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në:

a) Studime të Thelluara në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike, në përfundim të të cilave lëshohen diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.)”, përkatësisht, në Studime të Thelluara, në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike”.

b) Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.), në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri”.

c) Shëndet publik, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Shëndet publik”.

ç) Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.), në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës”.

d) Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji”.

dh) Studime të Thelluara në Kardiologji, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime të Thelluara në Kardiologji”.

e) Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale”.

ë) Studime në Neuroshkencë, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Neuroshkencë”.

f) Studime në Obstetrikë-Gjinekologji, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Obstetrikë-Gjinekologji”.

g) Mjekësi Laboratorike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Mjekësi Laboratorike”.

gj) Morfologji Klinike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Morfologji Klinike”.

h) Sëmundjet Kirurgjikale, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet Kirurgjikale”.

i) Imazheri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Imazheri”.

j) Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore”.

k) Sëmundjet e syrit, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet e syrit”.

l) Pediatri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Pediatri”.

ll) Shkencat farmaceutike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Shkencat Farmaceutike”.

m) Sëmundjet e brendshme, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet e Brendshme”.

3. Kohëzgjatja e programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin 2009, janë, si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Shkencave Sociale:

a) Doktoratë në Filozofi	24;
b) Doktoratë në Sociologji	30;
c) Doktoratë në Pedagogji	14;
ç) Doktoratë në Psikologji	20;
d) Doktoratë në Punë Sociale	12;
B. Fakulteti i Mjekësisë:	
a) Doktoratë në Studime të Thelluara në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike	10;
b) Doktoratë në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive, Emergjente dhe Riemergjente, në Shqipëri	16;
c) Doktoratë në Shëndetin Publik	12;
ç) Doktoratë në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës	12;
d) Doktoratë në Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji	10;
dh) Doktoratë në Studime të Thelluara në Kardiologji	6;
e) Doktoratë në Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale	16;
ë) Doktoratë në Studime në Neuroshkencë	16;
f) Doktoratë në Studime në Obstetrikë-Gjinekologji	10;
g) Doktoratë në Mjekësi Laboratorike	12;
gj) Doktoratë në Morfologji Klinike	10;
h) Doktoratë në Sëmundjet Kirurgjikale	20;
i) Doktoratë në Imazheri	10;
j) Doktoratë në Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore	10;
k) Doktoratë në Sëmundjet e Syrit	10;
l) Doktoratë në Pediatri	10;
ll) Doktoratë në Shkencat Farmaceutike	10;
m) Doktoratë në Sëmundjet e Brendshme	12.

5. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste, të caktuara nga fakulteti përkatës.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.855, datë 5.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE MINIERAVE, TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Gjeoshkencat, Burimet dhe Mjedisi”.
 2. Në përfundim të këtij programi lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Gjeoshkencat, Burimet dhe Mjedisi”.
 3. Kohëzgjatja e këtij programi studimesh është, të paktën, 3 (tri) vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
 4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 15.
 5. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste, të caktuara nga fakulteti përkatës.
 6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.
 7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.856, datë 5.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË “GJUHË-LETËRSI SHQIPE DHE FRËNGE”, NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e mësuesisë, të universitetit “Fan S. Noli”, të Korçës, të programit të studimit në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” DND, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.
2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale është 3 (tri) vite akademike.
3. Në përfundim të këtij programi studimi përfitohet “Diplomë e nivelit të parë” DND, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.
4. Ky program studimi do ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Fan S. Noli” të Korçës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli” të Korçës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.857, datë 5.8.2009

**PËR HAPJEN, NË QYTETIN E PESHKOPISË, TË FILIALEVE DHE TË PROGRAMEVE
TË STUDIMEVE, TË FAKULTETEVE TË EKONOMISË E TË ADMINISTRIMIT, TË
EDUKIMIT DHE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT
“ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI, NË
VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Peshkopisë, të filialeve të Fakulteteve të ekonomisë e të administrimit, të edukimit dhe të shkollës së lartë profesionale, të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

2. Filiali i Fakultetit të Ekonomisë dhe të Administrimit do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

a) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Financë-Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Financë-Kontabilitet;

b) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Financë-Bankë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Financë-Bankë;

c) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Menaxhim marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Menaxhim-marketing;

ç) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Administrim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Administrim biznesi.

3. Filiali i Fakultetit të Edukimit do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

a) Mësuesi, dega “Matematikë-Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në Matematikë-Fizikë;

b) Mësuesi, dega “Matematikë-Informatikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në Matematikë-Informatikë;

c) Mësuesi, dega “Informatikë-Anglisht”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në Informatikë-Anglisht;

ç) Mësuesi, dega “Gjuhë-Letërsi-Anglisht”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në Gjuhë-Letërsi-Anglisht;

d) Mësuesi, dega “Biologji-Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në Biologji-Kimi;

dh) Mësuesi dega “Psikologji-Sociologji”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në Psikologji-Sociologji;

e) “Proceset e formimit”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Mësuesi, në “Proceset e formimit”.

4. Filiali i Shkollës së Lartë Profesionale do të ofrojë programet e studimit, në:

a) “Infermieri të Përgjithshme”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Infermieri të Përgjithshme;

b) “Drejtësi”, me profil “Asistencë ligjore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë jouniversitare në Drejtësi”, me profil asistencë ligjore;

c) “Informatikë”, me profil “Rrjete kompjuterike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë jouniversitare në Informatikë”, në rrjete kompjuterike.

5. Programet e studimit të ciklit të parë, në filialet e Fakultetit të Ekonomisë e të Administrimit dhe të Edukimit, në qytetin e Peshkopisë, përcaktuar në pikat 2, 3 e 4, shkronja “a”, realizohen me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

6. Programet e studimit të ciklit të parë, në filialin e Shkollës së Lartë Profesionale, përcaktuar në shkronjat “b” e “c”, të pikës 4, realizohen me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

7. Këto programe studimi do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

8. Numri i kuotave të pranimeve, në këto programe studimi, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, është, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

TABELA E KUOTAVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË FILIALET E UNIVERSITETIT
“ALEKSANDËR MOISIU” TË DURRËSIT NË QYTETIN E PESHKOPISË,
VITI AKADEMIK 2009-2010

Tabelë nr.1

Nr.	Programi i studimit DNP	Kuota
1	Shkenca të administrimit	40
2	Mësuesi	90
3	Proceset e formimit	15
4	Infermieri e përgjithshme	20
	Programi i studimit jouniversitar	
1	Drejtësi (Asistencë Ligjore)	20
2	Informatikë (Rrjete kompjuterike)	20
	Gjithsej	205

VENDIM
Nr.861, datë 23.6.2009

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, AGJENCIVE TË ORGANIZATËS SË
KOMBEVE TË BASHKUARA, TË OBJEKTIT “REPARTI I PRESTARISË DHE ZYRA”,
NË ADMINISTRIM TË “NPV USHTRISË”, SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien në përdorim, pa shpërblim, agjencive të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për një periudhë 10 (dhjetëvjeçare), të objektit “Repart i prestarisë dhe zyra”, në administrim të “NPV ushtrisë”, sh.a. Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 5 251,4 (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje katër) m², nga të cilat 2 071,4 (dy mijë e shtatëdhjetë e një presje katër) m², sipërfaqe funksionale, për pajisjen e këtyre agjencive me zyra.

2. Autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes për të lidhur kontratën me këto agjenci.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.862, datë 22.7.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.463, DATË 5.7.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E
MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritetit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull, periudha “2008-2014” zëvendësohet me “2009-2014”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit, 2009-2014, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.864, datë 29.7.2009

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË
TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, të jetë 22 134, e ndarë, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë | 21 034; |
| b) Kuota për program të dytë studimi | 300; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 700; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 100. |

2. Kuota e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, përbëhet nga:

- | | |
|---|---------|
| a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 19 702; |
| b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 1 307; |
| c) Kuota për të verbërit (të veçanta) | 25. |

3. Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, ndahet, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi, ndërmjet institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, janë pasqyruar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuota e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet kandidatëve shqiptarë, nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. Administrimi i këtyre kuotave kryhet nga ministritë e arsimit dhe autoritetet përgjegjëse respektive, të cilat sjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat e kandidatëve fitues. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ua përcjell listat institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, janë pasqyruar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuota e pranimeve për të verbërit ndahet për kandidatët me statusin e të verbërit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi të merret vendimi i shoqatës së të verbëve.

6. Kuota e pranimeve për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga persona të interesuar.

7. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë:

I. Në Universitetin e Tiranës:

Për të gjitha programet e studimit, sipas fakulteteve përkatëse:

- | | |
|---------------------------------------|--------------|
| 1. Në Fakultetin e Shkencave Natyrore | 15 000 lekë. |
| 2. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja | 15 000 lekë. |
| 3. Në Fakultetin e Drejtësisë | 30 000 lekë. |
| 4. Në Fakultetin e Shkencave Sociale | 30 000 lekë. |

5. Në Fakultetin e Mjekësisë:	
a) Në programet e studimit në:	
i) "Farmaci"	30 000 lekë.
ii) "Stomatologji"	30 000 lekë.
iii) "Shëndet Publik"	30 000 lekë.
b) Në programin e studimit "Mjekësi"	25 000 lekë.
6. Në Fakultetin e Infermierisë	25 000 lekë.
7. Në Fakultetin e Histori-Filologjisë	20 000 lekë.
8. Në Fakultetin e Ekonomisë	25 000 lekë.
II. Në Universitetin Politeknik të Tiranës:	
1. Në programin e studimit "Arkitekturë"	30 000 lekë.
2. Në programin e studimit "Inxhinieri ndërtimi"	25 000 lekë.
3. Në programet e studimit:	
a) "Inxhinieri elektronike"	20 000 lekë.
b) "Inxhinieri telekomunikacioni"	20 000 lekë.
c) "Inxhinieri informatike"	20 000 lekë.
4. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
III. Në Akademinë e Arteve:	
1. Në programin e studimit "Regji filmi"	80 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	30 000 lekë.
IV. Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi"	
Për të gjitha programet e studimit	20 000 lekë.
V. Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:	
1. Në programet e studimit:	
a) "Drejtimit fermash dhe agrobiznes"	20 000 lekë.
b) "Ekonomi dhe politikë agrare"	20 000 lekë.
c) "Inxhinieri pyjesh"	20 000 lekë.
ç) "Inxhinieri e përpunimit të drurit"	20 000 lekë.
d) "Financë-kontabilitet"	20 000 lekë.
dh) "Mjekësi veterinare"	20 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
VI. Në universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit:	
1. Për programet e studimit për "Mësuesi"	12 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
VII. Në universitetin "Eqerem Çabej" të Gjirokastrës:	
Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
VIII. Në universitetin "Fan S. Noli" të Korçës:	
Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
IX. Në universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës:	
1. Në programet e studimit:	
a) "Gjuhë letërsi"	15 000 lekë.
b) "Punë sociale"	15 000 lekë.
c) "Psikologji"	15 000 lekë.
ç) "Drejtësi"	16 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
X. Në universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës:	
1. Në programet e studimit:	
a) "Drejtësi"	20 000 lekë.
b) "Gjuhë-letërsi"	15 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.

XI. Në universitetin “Aleksandër Moisiu” të Durrësit:

Për të gjitha programet e studimit

15 000 lekë.

8. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, të ciklit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si: të verbër/të shurdhër, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, e të ish-të përndjekurve politikë, përjashtohen nga tarifa e shkollimit. Nga kjo tarifë vjetore shkollimi përjashtohen edhe studentët e viteve më të larta, që vijnë nga këto shtresa sociale.

9. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

10. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me rezultate më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë-preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Këtë përjashtim, në asnjë rast, nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 8 (tetë).

11. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Transferimet e studentëve, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe statutin e rregulloret e tyre.

13. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë, në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

14. Kandidatët, që dëshirojnë të vijnë në një program të dytë studimi, e fitojnë këtë të drejtë, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe pa iu nënshtrohet detyrimeve të “Maturës Shtetërore”.

15. Kandidatët, që kërkojnë të studiojnë në një program të dytë studimi, në Akademinë e Arteve, në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve “Vojo Kushi”, në Tiranë, në programin e studimit të ciklit të parë “Edukimit fizik dhe sporte” të universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, të Elbasanit në programin e studimit të ciklit të parë “Pedagogji e specializuar”, në universitetin e Vlorës, dhe në programin e studimit “Arkitekturë” të Universitetit Politeknik të Tiranës, duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta (konkurset e pranimit), të vendosura nga vetë këto institucione.

16. Studentët, që vijnë në një program të dytë studimi i nënshtrohen tarifës së shkollimit, të përcaktuar në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të parealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme, në zbatim të këtij vendimi dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.	PROGRAMI I STUDIUMIT	UT	UP	UB	UE	UG	UK	UH	UV	AA	AFFS	UD	Σ
1	Histori	110						110					220
2	Gjeografi	110						110					220
3	Histori-Gjeografi				100	100							200
4	Gjuhë - Letërsi	110			120	100	90	120	150				690
5	Gazetari	80			100								180
6	Gazetari dhe Komunikim							80					80
7	Edokate Qytetare				110								110
8	Gjuhë Angleze	190			120	100	60	70	160				700
9	Gjuhë Angleze(Filial Sarandë)	35											35
10	Gjuhë Angleze(Filial Kukës)	35											35
11	Gjuhë Frënge	120			60			70					250
12	Gjuhë Italiane	130			70	80		80	160				520
13	Gjuhë Spanjolle	60											60
14	Gjuhë Ruse	60											60
15	Gjuhë Gjermane	110			60			70					240
16	Gjuhë Letërsi Greke - Qytetërim	50				60							110
17	Gjuhë Turke	60											60
18	Cikli i Uler				200	80	80	100	130				590
19	Cikli i Uler Parashkollor				100	80	60	60	100				400
20	Edokim Fizik dhe Sporte				50			70			150		270
21	Matematikë	100						60	150				310
22	Fizikë	80						50					130
23	Insh. Matematikë dhe Informatikë	100											100
24	Matematikë-Fizikë				120	60	80						300
25	Biologji - Kimi				120	60		120					330
26	Biologji	120											120
27	Kimi	70											70
28	Kimi ushqimor												70
29	Kimi Industriale	60											60
30	Matematikë-Informatikë					50	65						155
31	Informatikë	180						70	250				500
32	Teknologji Informatimi				60				250				310
33	Psue Sociale	120			110			70					300
34	Filozofi	110											110
35	Filozofi-Sociologji				110		90						200
36	Sociologji	110											110
37	Pedagogji e Specializuar								50				50
38	Psikologji	100			100			80					280
39	Shkencat Politike	110											110
40	Drejtësi	700						200	120				1020
41	Regji Filmi dhe TV									10			10

Nr.	PROGRAMI I STUDIUMIT	UT	UPT	UBF	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEEF	UD	Σ
42	Aktim									12			12
43	Regji									8			8
44	Skenografi-Kostumografi									12			12
45	Kortografi									12			12
46	Pikturë									50			50
47	Skulpturë									10			10
48	Muzikologji									3			3
49	Kompozim									3			3
50	Dirigjim									3			3
51	Piano									6			6
52	Violinë									10			10
53	Violonçel									6			6
54	Violë									5			5
55	Kitarë									6			6
56	Kontrabas									4			4
57	Flaut									3			3
58	Oboe									3			3
59	Klarnetë									3			3
60	Fagot									3			3
61	Korno									3			3
62	Trombe									5			5
63	Trombon									4			4
64	Bastub									3			3
65	Kengetar									15			15
66	Fizmonike klasike									5			5
67	Pedagogji muzikore									10			10
68	Shëndeti Publik	20											20
69	Mjekësi e Përgjithshme	250											250
70	Stomatologji	80											80
71	Farmaci	60											60
72	Infermieri e Përgjithshme	250			150	120	130	90	250				990
73	Infermieri (Kukës)	100											100
74	Mami (Infermieri)	60			100		60	75					295
75	Teknik i Arte Laboratori	40											40
76	Fizioterapi	40						35					75
77	Logopedi	50											50
78	Imazheri	40											40
79	Administrim Publik					80							80
80	Administrim-Biznes	470			100		100	100	240				1010
81	Ekonomiks	80											80
82	Ekonomia dhe E drejtua				100								100

Nr.	PROGRAMI I STUDIUMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	Σ
83	Finance-Kontabilitet	470			100	100	110	100					880
84	Informatike Ekonomike	75											75
85	Administr-Biznesi (Turizem/Fil Sarande	100											100
86	Administr-Biznes (Fil Kukës)	100											100
87	Turizem/Menaxhim					45	90	100	160				395
88	Turizem, filiali Pogradec						60						60
89	Marketing						90						90
91	Injineri Navigacioni								200				200
92	Injineri Mekanike		150						200				350
93	Injineri Metalurgji Materiale		50										50
94	Injineri Tekstile dhe Mode		50										50
95	Injineri Elektrike(Energjitike)		70										70
96	Injineri Elektrike/Aut. Industrise)		60										60
97	Injineri Elektronike		100										100
98	Injineri Informatike		150										150
99	Injineri Telekomunikacioni		100										100
100	Injineri Mekanike		50										50
101	Injineri Nderim		160										160
102	Injineri Hidroteknike		80										80
103	Aktikture		100										100
104	Injineri Matematike		50										50
105	Injineri Fizike		50										50
107	Injineri Gjeodet		60										60
108	Injineri Mjedis		50										50
109	Injineri ne Shkencat e Tokes		50										50
110	Injineri Gjeoinformatike		60										60
111	Injineri i Gjeoburimeve		60										60
112	Menaxhim Agrobiznesi			160			60						220
113	Menaxhim Agrobiznesi(Fil Lushnje)			60									60
114	Ekonomi dhe Politike Agrare			170									170
115	Finance-Kontabilitet			70									70
116	Finance-Kontabilitet(Filial Lushnje)												
117	Mbrojtje Bimësh			110									110
118	Hortikulture			110			60						170
119	Hortikulture (Filial Lushnje)			45									45
120	Prodhim bimor			110									110
121	Zoetkin dhe Biznes Blegjtoral			110									110
122	Akuaikulture dhe Menaxh. Peshkimi			110									110
123	Injineri Agromjedis dhe Ekologji			110									110
124	Teknologji Agrosqimor			110									110
125	Vrshitar-Endologji			70									70

Nr.	PROGRAMI I STUDIUMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEEF	UD	Σ
126	Inzhineri Pyjesh			90									90
127	Inzhineri Personim Dru			90									90
128	Mjekesi Veterinare			130									130
129	Agromekanizim (Insh Agromonike)			60									60
130	Agroushqim						70						70
131	Teknologji e prodhimit bimor						60						60
132	Shkencat e Administrimit											150	150
133	Menaxhim Turizmi											100	100
134	Cikletat											90	90
135	Anglisht											100	100
136	Procesi Formimi											60	60
137	Rijete Kompiuterike											60	60
138	Menaxhim Ndërtimi											35	35
139	Menaxhim Transporti											35	35
140	Teknologji Automobilash											35	35
141	Asistencë Llogjore											40	40
142	Asistencë Administrative											30	30
143	Infermier e Përgjithshme											50	50
144	Ndihesë në veprimtarinë dëmiare											30	30
	GJITHSEJ	5575	1500	1885	2270	1215	1415	2000	2570	217	150	815	19702

KUOTAT PER KANDIDATET NGA TROJET PER VITIN AKADEMIK 2009 - 2010

Tabela Nr.2

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	KOSOVA					MAQEDONIA					MALIZI					P	R	E	S	H	E	V	A	Σ
		UT	AA	UB	US	UE	AS	UD	UG	UV	UT	UP	UB	US	UA	UV									
1	Histori	2			4						1						2				1				17
2	Gjeografi	2			2						1						1				1				10
3	Histori-Gjeografi					2			5														5	1	15
4	Gjuhe - Letersi	2		2	2				5	3	1					3	5	2							51
5	Edukim Qytetar																								0
6	Gjuhe angleze	10		5	2				5	3	5														64
7	Gjuhe angleze (Fil. Kukës)	10																							10
8	Gjuhe italiane																								32
9	Gjuhe frenge			2	1				5	3															8
10	Gjuhe gjermane			2	1																				21
11	Gjuhe greke								5																10
12	Invsh. Matem. dhe Informa.	5									1														12
13	Cikli i Ulet			3	3				5	3															46
14	Cikli i Ulet Parashkollor			3	3				5	3															51
15	Edukim Fizik dhe Sporte			2	2	3																			23
16	Matematike	2		2					3	1															30
17	Matematike - Fizikë				3				5																20
18	Teknologji Informacioni				2				3																18
19	Matematike-Informatikë																								10
20	Fizikë	2		2							1														16
21	Biologji	2									1														5
22	Biologji-Kimi			2	3				5																29
23	Kimi	2									1														8
24	Kimi Ushqimorë	2									1														5
25	Kimi Industriale	2									1														5
26	Informatikë	2		2							1														17
27	Gazetari	2		2	2						1														23
28	Punë Sociale			2	2																				18
29	Sociologji																								3
30	Filozofi (Sociologji)				2				2																11
31	Psikologji			2	2																				17
32	Pedagogji e specializuar								3																10
33	Shtetëtar Politike																								3
34	Drejtesi	4		2						3	4														38

[illegible]

6287

**TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E DYTA TË STUDIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, CIKLI I PARË I STUDIMEVE,
VITI AKADEMIK 2009-2010**

Nr.	Programet e studimit	Tarifa në lekë
I	Universiteti Politeknik i Tiranës	
1	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	
	Arkitekturë	160 000
	Për të gjitha programet e tjera të studimit	120 000
2	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	
	Për të gjitha programet e studimit	120 000
3	Fakulteti i Gjeologji-Miniera	
	Inxhinieri gjeoinformatike	120 000
	Për të gjitha programet e tjera të studimit	100 000
4	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	
	Për të gjitha programet e studimit	100 000
5	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	
	Për të gjitha programet e studimit	100 000
6	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	
	Për të gjitha programet e studimit	100 000
II	Universiteti Bujqësor i Tiranës	
1	Fakulteti i Veterinarisë	
	Mjekësi Veterinare	120 000
2	Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
3	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	
	Për të gjitha programet e studimit	65 000
4	Fakulteti i Shkencave Pyjore	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
5	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	
III	Universiteti i Tiranës	
1	Fakulteti i Ekonomisë	
	Për të gjitha programet e studimit	65 000
2	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
3	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	
	Matematikë	65 000
	Fizikë	65 000
	Të gjitha programet e e tjera të studimit	100 000
4	Fakulteti i Mjekësisë	
	Për të gjitha programet e studimit	270 000
5	Fakulteti Histori-Filologji	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
6	Fakulteti i Drejtësisë	
	Drejtësi	50 000
7	Fakulteti i Shkencave Sociale	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000

8	Fakulteti i Infermierisë	
	Infermieri e përgjithshme	150 000
	Mami	130 000
	Teknikë e lartë laborator	130 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	110 000
IV	Universiteti i Gjirokastrës	
1	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	
	Cikli i Ulët	60 000
	Cikli i Ulët Parashkollor	60 000
	Kontabilitet-Financë	65 000
	Administrim Publik	65 000
	Turizëm	65 000
	Histori-Gjeografi	70 000
	Gjuhë-Letërsi	70 000
	Të gjitha programet e e tjera të studimit	80 000
2	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	
	Bio-Kimi	80 000
	Matematikë-Fizikë	60 000
	Matematikë-Informatikë	60 000
	Infermieri	100 000
V	Universiteti i Vlorës	
1	Fakulteti i Shkencave Teknike	
	Matematikë	65 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000
2	Fakulteti i Edukimit	
	Për të gjitha programet e studimit	60 000
3	Fakulteti i Ekonomisë dhe Drejtësisë	
	Juridik	50 000
4	Departamenti i Infermierisë	
	Infermieri e Përgjithshme	150 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	65 000
VI	Universiteti i Korçës	
1	Fakulteti i Ekonomisë	
	Për të gjitha programet e studimit	65 000
2	Fakulteti i Mësuesisë	
	Matematikë-Fizikë	60 000
	Matematikë-Informatikë	65 000
	Cikli i Ulët	60 000
	Cikli i Ulët Parashkollor	60 000
	Gjuhë-Letërsi	65 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000
3	Fakulteti i Bujqësisë	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
	Infermier i përgjithshëm	150 000
	Mami	130 000
VII	Universiteti i Elbasanit	
1	Fakulteti i Shkencave Natyrore	
	Matematikë-Fizikë	60 000
	Infermieri e përgjithshme	150 000

	Mami	130 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000
2	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	
	Cikli i Ulët	60 000
	Cikli i Ulët parashkollor	60 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000
3	Fakulteti i Shkencave Humane	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
4	Fakulteti i Ekonomisë	
	Për të gjitha programet e studimit	65 000
VIII	Universiteti i Shkodrës	
1	Fakulteti i Ekonomisë	
	Për të gjitha programet e studimit	65 000
2	Fakulteti i Drejtësisë	
	Drejtësi	50 000
3	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	
	Cikli i Ulët	60 000
	Cikli i Ulët Parashkollor	60 000
	Edukim Fizik dhe Sporte	150 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000
4	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	
	Matematikë	60 000
	Fizikë	60 000
	Infermieri e përgjithshme	150 000
	Mami	130 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000
5	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	
	Për të gjitha programet e studimit	82 000
6	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	
	Të gjitha programet e studimit	82 000
IX	Universiteti i Durrësit	
1	Fakulteti i Edukimit	
	Cikli i Ulët	60 000
	Të gjitha programet e tjera të studimit	82 000

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.848, datë 5.8.2009

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË SPITALIT USHTARAK, GJIROKASTËR, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të spitalit ushtarak, Gjirokastrë, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë.

2. Në listën e pronave, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja, truall, prej 5 261.7 (pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një presje shtatë) m², e zënë nga spitali ushtarak, Gjirokastrë, pjesë e pronës nr.593 “Shtabi i Brigadës”.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.853, datë 5.8.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.7.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.25336/04, “GRORI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore””, e të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 17.9.2009
 Doli nga shtypi më 17.9.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë